



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
*Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health*

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

**PËRSHKRIMI I DETYRAVE TË PUNËS TË STAFIT SHËNDETËSOR TË BURGJEVE  
TË KOSOVËS**

## Përmbajtja:

<b>PËRSHKRIMI I DETYRAVE TË PUNËS TË STAFIT SHËNDETËSOR TË BURGJEVE TË KOSOVËS</b> .....	1
1. DREJTOR I DEPARTAMENTIT SHËNDETËSOR TË BURGJEVE.....	4
2. KOORDINATOR PËR SHËNDETËSI NË BURGJE .....	5
3. KOORDINATOR PËR SHËNDET MENDOR NË BURGJE .....	6
4. KOORDINATOR PËR SHËRBIME FARMACEUTIKE NE BURGJE .....	7
5. KOORDINATOR PËR TE DHËNA, TERMINE DHE PËRSONEL NE DSHB .....	8
6. UDHËHEQËS I NJSHB NË DUBRAVË .....	9
7. UDHËHEQËS I NJSHB NË QENDER KORREKTUESE.....	11
8. UDHËHEQËS I NJSHB NË QENDER PARABURGIMI.....	12
9. MJEK NË NJSHB.....	13
10. PSIKOLOG NË NJSHB .....	14
11. DENTIST NË NJSHB .....	15
12. PSIKIATER NË BURG.....	15
13. PSIKIATER KONSULTANT .....	16
14. TEKNIK I RADIOLOGJISE.....	17
15. GJINEKOLOG KONSULTANT.....	18
16. RADIOLOG KONSULTANT.....	19
17. ORTOPEDE KONSULTANT .....	20
18. OFTALMOLOG KONSULTANT .....	20
19. UROLOG KONSULTANT .....	21
20. OTORINOLARINGOLOG KONSULTANT.....	22
21. KIRURG KONSULTANT .....	22
22. FIZIATER KONSULTANT .....	23

23.	FIZIOTERAPEUT KONSULTANT .....	24
24.	PULMOLOG KONSULTANT.....	25
25.	KARDIOLOG KONSULTANT .....	26
26.	NEUROLOG KONSULTANT .....	26
27.	DERMATOVENEROLOG KONSULTANT.....	27
28.	SPECIALISTI KONSULTANT TJETER NE BURGJE.....	28
29.	KRYEINFERMIER NË STACIONARIN E NJSHB NË DUBRAVË.....	29
30.	KRYEINFERMIER NË NJSHB NË QENDER PARABURGIMI .....	30
31.	UDHËHEQËS NDRRIMI NË NJSHB.....	31
32.	TEKNIK I FARMACISË NË NJSHB .....	32
33.	INFERMIER NË NJSHB.....	33
34.	TEKNIK KOORDINATOR I LABORATOREVE NË DSHB .....	34
35.	LABORANT TEKNIK NË NJSHB .....	34
36.	INFERMIER I KOORDINATOR NE SHSKUK .....	35
37.	ZYRTARET PËR ÇËSHTJE LIGJORE TË DSHB .....	36
38.	ZYRTARET PËR BUXHET DHE FINANCA TË DSHB.....	37

# **1. DREJTOR I DEPARTAMENTIT SHËNDETËSOR TË BURGJEVE**

**Vendi: Ministria e Shëndetësisë**

## **Detyra dhe përgjegjësitë**

1. Të jetë përgjegjës për funksionimin e të gjitha shërbimet shëndetësor në të gjitha Njësitë Shëndetësore të burgjeve.
2. Të menaxhoj punën e shëndetësisë në burgje dhe të koordinatorëve në DShB (Koordinatori për shëndetësi, shëndet mendor, farmaci dhe për te dhëna e termine), komisioneve dhe trupave të tjera të ngritura për nevoja të Departamentit.
3. Të mbikëqyr punën stafit mjekësor që punon në kuadër të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, gjegjësisht NjShB përmes Udhëheqësve të NjShB-ve dhe të menaxhoj emërimet dhe procedurat sipas nevojave dhe kërkesave të shërbimeve në dobi të funksionimit dhe ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
4. Monitorimi i punës së institucioneve shëndetësore në burgje (8 ambulancave, 2 stacionareve shëndetësor, 1 institucioni për kujdes shëndetësor për personat me nevoja të veçanta dhe 1 institucioni shëndetësor për kujdesin e nënës dhe fëmijës);
5. Aplikimin e planit të veprimit nga strategjia sektoriale e MSH-se për shëndetësinë në burgje lidhur me funksionimin e këtij shërbimi në harmoni me rregullat e sigurisë së burgjeve;
6. Bashkëpunimin e ngushtë me Organin Qendror të Administratës Shtetërore /SHKK/MD dhe me drejtorët e burgjeve, të cilat janë pjesë e Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të ofrimit të kujdesit shëndetësor të njëjte si për qytetaret e lirë, si dhe bashkëpunimin me gjykatat dhe prokuroritë për trajtimin, ekspertizën dhe raportimin shëndetësor dhe psikiatrike për persona të caktuar sipas kërkesës;
7. Aplikimin e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në aspektin shëndetësor;
8. Mbikëqyrjen e rregullt të kushteve higjieniko-sanitare, ushqimit dhe ujit në burgje si dhe marrjen e masave të vazhdueshme për parandalimin e epidemive dhe marrjen e masave kundër epidemike në rast nevoje;
9. Dhënien e këshillave profesionale për rastet vështirë të menaxhueshme dhe rasteve që kërkojnë trajtim multidisiplinar dhe nder sektorial;
10. Bashkëpunimin me të gjitha institucionet shëndetësore të vendit duke filluar nga ato të shëndetit primar, sekondar, terciar si dhe menaxhimin e dhomave të sigurta në institucione shëndetësore publike dhe menaxhimin për trajtim të burgosurve në institucione shëndetësore publike;
11. Mbështetje në menaxhimin e situatave të komplikuar në burgje të cilat lidhen me shëndetin si grevat e urisë, tentim vetëvrasjet, dhunën në burgje, vdekjet në burgje etj.
12. Funksionimi i këtij Departamenti realizohet përmes Njësisve Shëndetësore të vendosura në secilin burg (10).
13. Aktivitetet nga përgjegjësia e Departamentit menaxhohen në bashkëpunim me koordinatorët përgjegjës për çështje specifike;
14. Emëron pozitat udhëheqëse të NjShB-ve ( mjekun përgjegjës, kryeinfermierin etj);
15. Udhëheqësi i Departamentit shëndetësor të burgjeve raporton tek Ministri i Shëndetësisë.

**Kushtet:**

- Diplomë Universitare apo titull shkencor i nivelit master apo doktoratës në mjekësi, shëndet publik;
- Së paku 7 vite përvojë pune në burgje.
- Së paku 5 vite përvojë menaxheriale dhe aftësi për të udhëheqë ekipin e përzier të punëtorëve profesional e teknik.
- Njohje e mirë e politikave dhe legjislacionit të sistemit të shëndetësisë dhe të sistemit të drejtësisë, veçanërisht të çështjeve që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve shëndetësore në burgje;
- Aftësi të mira të koordinimit, komunikimit dhe ndër-personale;
- Aftësi për të komunikuar dhe shpjeguar çështjet komplekse teknike në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;
- Njohuri dhe shkathtësi të mira të punës me kompjuter;
- Njohje shumë e mirë e gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës, të folur dhe me shkrim, dhe njohuri të mira të gjuhës angleze;

## **2. KOORDINATOR PËR SHËNDETËSI NË BURGJE**

**Vendi:** **Ministria e Shëndetësisë**

**Detyra dhe përgjegjësitë**

1. Të menaxhoj çështjet shëndetësore në të gjitha NjShB.
2. Të jetë përgjegjës për strategjinë, planin dhe punën e stafit në lidhje me:
  - a. Çështjet shëndetësore në përgjithësi
  - b. Aplikimin e masave cilësore shëndetësore.
  - c. Monitorimin e mënyrës së aplikimit të parandalimit, trajtimit dhe rehabilitimit të shërbimeve shëndetësore në NjShB.
  - d. Monitorimin e implementimit të planit strategjik dhe planit të punës.
  - e. Monitorimin e përdorimit të pajisjeve dhe barërave në dobi të shëndetit.
  - f. Monitorimin e çështjeve etike, profesionale, trajnimeve, mënyrën e menaxhimit të indikatorëve specifik, përdorimin e protokolleve etj.
3. Të koordinoj punën me organizmat përkatës të MSh për ofrimin e trajnimeve, protokolleve dhe trajtimeve unike të të gjitha çështjeve shëndetësore.
4. Të bëjë vizita të rregullta nëpër institucione dhe të vizitoj rastet specifike në të gjitha institucionet.
5. Të krijoj kushte dhe mundësi për trajtimin shëndetësor të rasteve shëndetësore në burgje dhe jashtë tyre si dhe menaxhimin e rasteve specifike.
6. Të monitoroj dhomat e sigurta në spitalet regjionale dhe ato të QKUK-se.
7. Të monitoroj dhe koordinoj punën e infermieres koordinatorë të dhomave të ShSKUK.

8. Të mbështesë koordinatoret e tjerë dhe Udhëheqësit e NJSHB-ve ne punën e tyre rutine dhe ne raste specifike.
9. Të jetë i gatshëm për detyra tjera shtese ne rrethana specifike dhe sipas nevojës.
10. Koordinatori për shëndetësi ne burgje i përgjigjet drejte për se drejti Drejtorit te DShB.

**Kushtet:**

- Diplomë Universitare ne mjekësi, apo titull shkencor apo specializimi ne mjekësi familjare ose shëndet publik;
- Së paku 5 vite përvojë pune ne burgje.
- Njohje e mirë e politikave dhe legjislacionit të sistemit të shëndetësisë dhe të sistemit të drejtësisë, veçanërisht të çështjeve që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve shëndetësore në burgje;
- Aftësi të mira të koordinimit, komunikimit dhe ndërpersonale;
- Aftësi për të komunikuar dhe shpjeguar çështjet komplekse teknike në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;
- Njohuri dhe shkathtësi të mira të punës me kompjuter;
- Njohje shumë e mirë e gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës, të folur dhe me shkrim, dhe njohuri të mira të gjuhës angleze;

### **3. KOORDINATOR PËR SHËNDET MENDOR NË BURGJE**

**Vendi:** **Ministria e Shëndetësisë**

**Detyra dhe përgjegjësitë**

1. Te menaxhoj shëndetin mendor në të gjitha NjShB.
2. Të jetë përgjegjës për strategjinë, planin dhe punën e stafit në lidhje me:
3. Shëndetin mendor në përgjithësi
4. Parandalimi i vetëvrasjeve dhe trajtimin e rasteve me rrezik.
5. Parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve te vartësisë.
6. Të koordinoj punën me organizmat përkatës të MSh për ofrimin e trajnimeve, protokolleve dhe trajtimeve unike te të gjitha çrregullimeve mendore.
7. Të bëjë vizita të rregullta nëpër institucione dhe të vizitoj rastet specifike në të gjitha institucionet.
8. Të krijoj kushte dhe mundësi për trajtimin multidisiplinar të rasteve specifike.
9. Të jetë i gatshëm për detyra tjera shtese në rrethana specifike dhe sipas nevojës.
10. Koordinatori për shëndet mendor në burgje i përgjigjet drejt për së drejti Drejtorit të DShB.

**Kushtet:**

- Diplomë Universitare apo titull shkencor i nivelit master në psikologji, mjekësi;
- Së paku 5 vite përvojë pune ne burgje.

- Njohje e mirë e politikave dhe legjislacionit të sistemit të shëndetësisë dhe të sistemit të drejtësisë, veçanërisht të çështjeve që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve shëndetësore në burgje;
- Aftësi të mira të koordinimit, komunikimit dhe ndërpersonale;
- Aftësi për të komunikuar dhe shpjeguar çështjet komplekse teknike në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;
- Njohuri dhe shkathhtësi të mira të punës me kompjuter;
- Njohje shumë e mirë e gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës, të folur dhe me shkrim, dhe njohuri të mira të gjuhës angleze;

## **4. KOORDINATOR PËR SHËRBIME FARMACEUTIKE NE BURGJE**

**Vendi:** **Ministria e Shëndetësisë**

**Detyra dhe përgjegjësitë**

1. Te menaxhoj shërbimet farmaceutike ne te gjitha NjShB.
2. Te jete përgjegjës për strategjinë, planin e punës ne lidhje me:
  - a. Furnizimin me barëra dhe produkte medicinale
  - b. Shpenzimet, evidentimin dhe menaxhimin e shpenzimeve ne NjShB
  - c. Menaxhimin dhe monitorimin e porosive te barërave dhe produkteve medicinale nga NjShB –te ne harmoni me rregulloret dhe nevojat
  - d. Përcaktimin e periudhës se furnizimeve dhe raportimeve adekuatë
  - e. Te monitoroj menaxhimin e ruajtjes se produkteve dhe pajisjeve medicinale konform Praktikave te Mira Farmaceutike.
3. Te monitoroj, sugjeroj, trajnoj dhe këshilloj stafin mjekësor te institucioneve lidhur me menaxhimin e depove, rregulloreve për shpenzimin e barërave etj
4. Te raportoj ne mënyre periodike dhe te jashtëzakonshme, ne çdo kohe Drejtorin e DShB lidhur me gjendjen me barëra, porosite eventuale dhe te gjitha çështjet e tjera lidhur me menaxhimin e tyre.
5. Çdo herë dhe pa ndërprerje gjatë punës të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të stafit të mesëm ( teknikëve mjekësor) dhe avancimin e punës se tyre
6. Te filloj procedurat për menaxhim te listës se barërave ne mënyrë periodike ne varësi nga nevojat dhe ndryshimet ne shkencën e farmakologjisë.
7. Te menaxhoj depon qendrore ne funksion te ruajtjes, shpërndarjes dhe efikasitet për te pasur barëra ne çdo kohe për te burgosur.
8. Te jete i gatshëm për detyra tjera shtese ne rrethana specifike dhe sipas nevojës.
9. Koordinatorin për shërbime farmaceutike ne burgje i përgjigjet drejte për se drejti Drejtorit te DShB.

**Kushtet:**

- Diplomë Universitare apo titull shkencor i nivelit master në farmakologji apo mjekësi;
- Së paku 5 vite përvojë pune në burgje.
- Njohje e mirë e politikave dhe legjislacionit të sistemit të shëndetësisë dhe të sistemit të drejtësisë, veçanërisht të çështjeve që kanë të bëjnë me sektorit farmaceutik;
- Aftësi të mira të koordinimit, komunikimit dhe ndërpersonale;
- Aftësi për të komunikuar dhe shpjeguar çështjet komplekse teknike në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;
- Njohuri dhe shkathtësi të mira të punës me kompjuter;
- Njohje shumë e mirë e gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës, të folur dhe me shkrim, dhe njohuri të mira të gjuhës angleze;

## **5. KOORDINATOR PËR TE DHËNA, TERMINE DHE PËRSONEL NE DSHB**

**Vendi:** **Ministria e Shëndetësisë**

### **Detyra dhe përgjegjësitë**

1. Te menaxhoj dosjet personale te stafit mjekësor te DShB-se ne koordinim me zyrën e personelit te MSh dhe Udhëheqësit e NjShB-ve.
2. Te menaxhoj kompletimin e dosjeve personale, pushimeve, masave disiplinore, masave etike, pagave, shtesave, mëditjeve, heqjeve te mëditjeve e te tjera lidhur me pagat.
3. Te mbikëqyr plotësimin e dokumentacionit dhe përmbushjen e kontratës se punës.
4. Te menaxhoj kontrate e punës se te punësuarve.
5. Te menaxhoj te gjitha te dhënat nga te gjitha NjShB si:
  - a. Te ketë kontakte te përditshme me përgjegjësit e NjShB ne funksion te informimit reciprok
  - b. Monitorimin e te dhënave te përcaktuara me raporte ne baza periodike nga te gjitha NjShB
  - c. Menaxhimin dhe përpunimin e te dhënave për te prodhuar raporte periodike gjithë përfshirëse
6. Te menaxhoj te gjitha lëvizjet e te burgosurve për shkaqe shëndetësore, përmes:
  - a. Informatave ditore nga NjShB-te
  - b. Menaxhimit te terminëve ne SHSKUK për rastet e kërkuara nga burgjet,
  - c. Vizitave periodike te pacienteve te burgosur, te shtrire ne spitale civile ne funksion te mbështetjes dhe mbledhjes se raporteve nga spitalet për nevoja juridike.
  - d. Koordinimin e punëve shëndetësore me njësinë përkatëse te sigurisë ne ShKK.
7. Te plotësoje dhe mbaje dosjet për te gjitha ato aktivitetet e kryera.



8. Te jete përgjegjëse për te dhënat për lëvizjet e te burgosurve ne institucione publike shëndetësore.
9. Te kompletoj aktivitetet tjera për zyrën e Drejtorit te DShB.
10. Te jete i gatshëm për detyra tjera shtese ne rrethana specifike dhe sipas nevojës.
11. Koordinatori për te dhëna dhe termine dhe personel ne DShB i përgjigjet drejte për se drejti Drejtorit te DShB.

#### **Kushtet:**

- Diplomë Universitare mjekësi, psikologji, specializim apo titull shkencor i nivelit master
- Së paku 5 vite përvojë pune ne burgje.
- Njohje e mirë e politikave dhe legjislacionit të sistemit të shëndetësisë dhe të sistemit të drejtësisë;
- Aftësi të mira të koordinimit, komunikimit dhe ndërpersonale;
- Aftësi për të komunikuar dhe shpjeguar çështjet komplekse teknike në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;
- Njohuri dhe shkathtësi të mira të punës me kompjuter, në përdorimin e procedimin në word, përdorimin e internetit dhe të bazave të dhënave;
- Njohje shumë e mirë e gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës, të folur dhe me shkrim, dhe njohuri të mira të gjuhës angleze;

## **6. UDHËHEQËS I NJSHB NË DUBRAVË**

Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Drejtorit të DShB/MSh
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohe te caktuar
Vendi:	NjSHB-Stacionari ne Dubravë

*Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Stacionarit në NjShB Dubravë:*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta, orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë), sigurinë dhe rutinën.
4. Të ketë përgjegjësi të drejtpërdrejt për shëndetin e të gjithë pacientëve të tij pa dallim kombësie dhe feje;
5. Të jetë përgjegjës për kushtet e jetesës për pacientët e tij në aspektin shëndetësor si:
  - uji – kualiteti dhe kuantiteti
  - ushqimi – kualiteti dhe kaloritet
  - higjiena personale dhe kolektive
  - shëndeti mental

- ambienti dhe kushtet e jetesës
  - respektimi i të drejtave të njeriut
  - Ruajtja e konfidencialitetit dhe ofrimi i kushteve për trajtim konfidencial.
6. Të jetë përgjegjës për aplikimin e standardeve optimale shëndetësore si:
    - pajisjet adekuate mjekësore, administrative e të tjera
    - stafin e mjaftueshëm dhe profesional
    - barërat adekuate dhe me afat
    - shpërndarja e barërave me kohë dhe e rregullt
    - mundësimin e vizitave të pacientëve sipas prioriteteve të përcaktuara
    - intervenimet me kohë në rastet urgjente
    - gatishmëria e vazhdueshme, në çdo kohë
    - dërgimet jashtë institucionit për trajtim adekuat kur nuk ka kushte dhe mundësi brenda institucionit
    - orarin dhe respektimin e orarit nga punëtorët e tij
    - pamundësimin e shkeljes së këtyre rregullave
  7. Të jetë përgjegjës i drejtpërdrejtë për furnizimin ose jo furnizimin adekuat dhe me kohë më barëra dhe pajisje tjera mjekësore.
  8. Të jetë menaxher i mirë dhe të ketë nën përgjegjësin e tij punën e stafit të tij
  9. Të ju sigurojë kushte dhe hapësirë për punë stafit të tij si dhe të jetë kolegjial dhe i arsyeshëm në raport me stafin që e menaxhon;\
  10. Çdo raport apo vendim i stafit të tij të shkojë drejtpërdrejt përmes tij
  11. Të jetë në kontakt të vazhdueshëm dhe urë lidhëse me institucionet shëndetësore civile dhe institucionit të tij
  12. Të jetë mbrojtës, mbikëqyrës dhe reprezentues i denjë i stafit të tij
  13. Të përgjigjet me profesionalizëm dhe përgjegjësi kërkesave dhe sfidave të reja që i paraqiten si dhe të jetë elastik në punë, po ashtu të marrë përgjegjësin për shpërndarjen adekuate dhe të mjaftueshme të stafit
  14. Të jetë veçmas në raport të mirë me drejtorinë e institucionit dhe çdo raportim jashtë institucionit të bëhet përmes drejtorit të institucionit
  15. Të japë përgjegjësi të drejtë për drejtë profesionale të Drejtorit të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve në MSh për punën e bërë si dhe të bëjë raportimin adekuat periodik të përcaktuar dhe precizuar më parë.
  16. Të koordinojë dhe të jete përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së mjekëve konsulltant. Të jetë çdo here në dijeni për të gjitha specifikat e punës së tyre
  17. Të ketë nën mbikëqyrje të gjitha pjesët përbërëse të institucionit, si:
    - Pjesën e pranimit të pacientëve
    - Pjesën e lirimimit të pacientëve
    - Pjesën e hospitalizimit të pacientëve
    - Mbikëqyrjen e aftësive punuese të pacientëve
    - Mbikëqyre ftesën shëndetësore për pushime dhe vikende të burgosurve
    - Mbikëqyrjen e aftësive për pushime dhe vikende të pacientëve
    - Përgatitjen e dokumentacionit për lirimim me kusht të pacientëve
    - Propozimet e ndryshme për drejtorin për lirimim të pacientëve për shkaqe shëndetësore
    - Përgjigjet me shkrim të ankesave të pacientëve si dhe kërkesave të drejtorisë së burgut, drejtorisë së DSHB e SHKK/MD dhe Gjykatave.

- Mbikëqyrjen e preventivës mjekësore dhe aplikimin e masave kundër epidemive të mundshme.
- Raportimin e sëmundjeve infektive dhe të tjera sipas ligjeve në fuqi.
- Të këtë kontakte të drejtpërdrejta me stafin e tij punues, veçmas mjekët dhe konsultantet.
- Te koordinoj ngushte punët me Infermierin kryesor për çdo detal menaxhues në institucion.

## 7. UDHËHEQËS I NJSHB NË QENDER KORREKTUESE

Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Drejtorit të DShB/MSh
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohe të caktuar
Vendi:	NjSHB në QK

### *Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të NjShB në Qendra Korrektuese*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta, orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë), sigurinë dhe rutinën
4. Të ketë përgjegjësi të drejtpërdrejt për shëndetin e të gjithë pacientëve të tij pa dallim
5. Të jetë përgjegjës për kushtet e jetesës për pacientët e tij në aspektin shëndetësor si:
  - uji – kualiteti dhe kuantiteti
  - ushqimi – kualiteti dhe kaloritet
  - higjiena personale dhe kolektive
  - shëndeti mental
  - ambienti dhe kushtet e jetesës
  - respektimi i të drejtave të njeriut
6. Ruajtja e konfidencialitetit dhe ofrimi i kushteve për trajtim konfidencial
7. Të jetë përgjegjës për aplikimin e standardeve optimale shëndetësore si:
8. Të jetë përgjegjës i drejtpërdrejtë për furnizimin ose jofurnizimin adekuat dhe me kohë më barëra dhe pajisje tjera mjekësore
9. Të jetë menaxher i mirë dhe të ketë nën përgjegjësin e tij punën e stafit të tij
10. Tu sigurojë kushte dhe hapësirë për punë stafit të tij si dhe të jetë kolegial dhe i arsyeshëm në raport me ta
11. Çdo raport apo vendim i stafit të tij të shkojë drejtpërsëdrejti vetëm përmes tij
12. Të jetë në kontakt të vazhdueshëm dhe urë lidhëse me institucionet shëndetësore civile dhe institucionit të tij
13. Të jetë mbrojtës, mbikëqyrës dhe reprezentues i denjë i stafit të tij
14. Të përgjigjet me profesionalizëm dhe përgjegjësi kërkesave dhe sfidave të reja që i paraqitën si dhe të jetë elastik në punë, po ashtu të marrë përgjegjësin për shpërndarjen adekuate dhe të

mjaftueshme të stafit

15. Të jetë veçmas në raport të mirë me drejtorinë e institucionit dhe çdo raportim jashtë institucionit të bëhet përmes drejtorit të institucionit
16. Udhëheqësi i NjShB në Qendrën Korrektuese i përgjigjet drejte për së drejti Drejtorit të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve në MSh.
17. Te koordinoje dhe te jete përgjegjës për mbarëvajtjen e punës se mjekeve konsulltant. Të jetë çdo here ne dijeni për te gjitha specifikat e punës se tyre
18. Të ketë nën mbikëqyrje të gjitha pjesët përbërëse të institucionit.

## 8. UDHËHEQËS I NJSHB NË QENDER PARABURGIMI

Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Drejtorit të DShB/MSh
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohë të caktuar
Vendi:	NjSHB në QP

*Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të NjShB në Qendra Paraburgimi*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta, orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë), sigurinë dhe rutinën
4. Të ketë përgjegjësi të drejtpërdrejt për shëndetin e të gjithë pacientëve të tij pa dallim
5. Të jetë përgjegjës për kushtet e jetesës për pacientët e tij në aspektin shëndetësor si:
  - uji – kualiteti dhe kuantiteti
  - ushqimi – kualiteti dhe kaloritë
  - higjiena personale dhe kolektive
  - shëndeti mental
  - ambienti dhe kushtet e jetesës
  - respektimi i të drejtave të njeriut
  - Ruajtja e konfidencialitetit dhe ofrimi i kushteve për trajtim konfidencial
6. Të jetë përgjegjës për aplikimin e standardeve optimale shëndetësore si:
  - stafin e mjaftueshëm dhe profesional
  - barërat adekuate dhe me afat
  - shpërndarja e barërave me kohë dhe e rregullt
  - mundësimin e vizitave të pacientëve sipas prioriteteve të përcaktuara
  - intervenimet me kohë në rastet urgjente
  - dërgimet jashtë institucionit për trajtim adekuat kur nuk ka kushte dhe mundësi brenda institucionit
  - orarin dhe respektimin e orarit nga punëtorët e tij
  - pamundësimin e shkeljes së këtyre rregullave

7. Të jetë përgjegjës i drejtpërdrejtë për furnizimin ose jofurnizimin adekuat dhe me kohë më barëra dhe pajisje tjera mjekësore
8. Të jetë menaxher i mirë dhe të ketë nën përgjegjësin e tij punën e stafit të tij
9. Tu sigurojë kushte dhe hapësirë për punë stafit të tij si dhe të jetë kolegjial dhe i arsyeshëm në raport me ta
10. Çdo raport apo vendim i stafit të tij të shkojë drejtpërsëdrejti vetëm përmes tij
11. Të jetë në kontakt të vazhdueshëm dhe urë lidhëse me institucionet shëndetësore civile dhe institucionit të tij
12. Të jetë mbrojtës, mbikëqyrës dhe reprezentues i denjë i stafit të tij
13. Të përgjigjet me profesionalizëm dhe përgjegjësi kërkesave dhe sfidave të reja që i paraqitën si dhe të jetë elastik në punë, po ashtu të marrë përgjegjësin për shpërndarjen adekuate dhe të mjaftueshme të stafit
14. Të jetë veçmas në raport të mirë me drejtorinë e institucionit dhe çdo raportim jashtë institucionit të bëhet përmes drejtorisë
15. Udhëheqësi i NjShB në Qendrën e Paraburgimit i përgjigjet drejtpërsëdrejti për së drejti Drejtorit të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve në MSh.
16. Të ketë nën mbikëqyrje të gjitha pjesët përbërëse të institucionit.

## 9. MJEK NË NJSHB

Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJSHB
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohe te pa caktuar
Vendi:	NJSHB

### *Detyrat dhe përgjegjësitë e mjekut në NjShB*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të jete përgjegjës për trajtimin shëndetësor komplet të të gjithë të burgosurve nën përgjegjësinë e tij duke përcjell, trajtuar dhe duke aplikuar terapinë e përshkruar nga ai ose specialisti.
3. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
4. Të respektojë specifikat e institucionit si:
  - a. rregulloret e veçanta
  - b. orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë)
  - c. sigurinë dhe rutinën
  - d. të bëjë referimin dhe triazhimin e pacienteve tek specialisti përkatës
5. Udhëheqësi i njësisë i jep urdhra dhe sugjerime mjekut të burgut.
6. Mjeku i stacionarit raporton tek Udhëheqësi i NjShB-se;
7. Çdo raportim dhe çdo veprim që del jashtë suazave të kompetencave të tij duhet të shkojë përmes Udhëheqësit të NjShB.
8. Të jetë përgjegjës për punën e vetë në institucion si dhe për grupin specifik të pacientëve që janë nën përgjegjësinë e tij pa diskriminim
9. Mundësisht të respektojë, aq sa është e mundur listën e barërave që posedon institucioni

10. Të bëjë përpjekje aktive dhe të vazhdueshme për avansimin profesional dhe organizativ të punës në institucion
11. Çdo herë dhe pa ndërprerje gjatë punës të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të stafit të mesëm ( infermiereve mjekësor)
12. Vendimet dhe aktivitetet e tij mos jenë në kundërshtim me rregullat e parashtruara më parë nga Udhëheqësi i NjShB në veçanti dhe institucioni në përgjithësi
13. Të gjitha raportet dhe evidencat ti bëjë me shkrim dhe me kohë
14. Çdo mosmarrëveshje mund të zgjidhet në bisedë me Udhëheqësin e NjShB.

## 10. PSIKOLOG NË NJSHB

Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJSHB
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohë të pa caktuar
Vendi:	NJSHB

### *Detyrat dhe përgjegjësitë e psikologut në NjShB*

1. Të punoj ne bashkëpunim te ngushtë me Udhëheqësin e Njësisë Shëndetësore të Burgut dhe te jetë nën mbikëqyrjen direkte administrative te tij.
2. Të bashkëpunoj ngushte me Psikiatrin dhe te jepe përgjegjësi te plote profesionale drejtpërdrejt te Psikologu Koordinues.
3. Të jete përgjegjës për shërbimin psikologjik për institucionin qe është i ngarkuar.
4. Të beje vizita te rregullta te të gjitha rasteve ne pranim dhe te jep vlerësimin psikologjik
5. Të menaxhoj te gjitha rastet specifike ne mënyrë te drejtpërdrejte.
6. Të menaxhoj te gjitha rastet me probleme si: Seanca psikologjike me rastet me tentim te vetëvrasjes, vetëlëndimeve si dhe probleme emocionale etj.
7. Të menaxhoj me seanca psikologjike te gjitha rastet qe janë përdorues te duhanit, alkoolit, drogave etj.
8. Të bëjë raporte psikologjike për Udhëheqësin e NjShB, Drejtorin e Burgut, Psikologun Koordinues, Drejtorin Shëndetësor te DSHB-së, Drejtorin Korrektues, autoritetet gjyqësore etj.
9. Të bëjë raportet psikologjike për Komisionin për Lirim me Kusht.
10. Vlerësim Psikologjik
11. Të bëjë raporte direkt, dhe te paraqes raste për Komisionin Multidisiplinar tek Udhëheqësi i NjShB, Psikologu Koordinator dhe Drejtori i Burgut ne bashkëpunim me psikiatrin konsulent.
12. Të japë këshilla psikologjike për te gjitha rastet specifike për udhëheqësit e institucioneve dhe Udhëheqësi i NjShB.
13. Të jetë i gatshëm për detyra tjera shtesë në rrethana specifike dhe sipas nevojës.

## 11. DENTIST NË NJSHB

Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJSHB
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohë të pa caktuar
Vendi:	NJSHB

### *Detyrat dhe përgjegjësitë e dentistit në NjShB*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta, orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë), sigurinë dhe rutinën
4. Të jetë i gatshëm për punë në çdo kohë sipas nevojës së institucionit dhe me orar të plotë.
5. Të konsultohet çdo herë me Udhëheqësin e NjShB të pacientit për çdo veprim lidhur me të.
6. Dentisti është përgjegjës për:
  - a) Parandalim e sëmundjeve të dhëmbëve
  - b) Edukimin shëndetësor të kujdesit oral,
  - c) Trajtimin adekuat dhe komplet të dhëmbëve
  - d) Kujdes tjetër për shëndetin dentar të të gjithë të dënuarve
  - e) Detyra të tjera profesionale sipas nevojës dhe kërkesës.
7. Të respektohen specifikat dhe lista e barërave dhe pajisjeve dentare që ka institucioni

## 12. PSIKIATER NË BURG

Orari i punës:	Normë të plotë
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJSHB-DSHB\MSH
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohë të pa caktuar
Vendi:	NJSHB

### *Detyrat dhe përgjegjësitë e psikiatrit në NjShB*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta, orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë), sigurinë dhe rutinën.
4. Jep sugjerime Udhëheqësit të NjShB-së dhe raporton tek ai.
5. Çdo raportim dhe çdo veprim që del jashtë suazave të kompetencave të tije duhet të shkojë përmes Udhëheqësit të NjShB.
6. Të jetë përgjegjës për punën e vetë në institucion si dhe për grupin specifik të pacientëve

- që janë nën përgjegjësinë e tij pa diskriminim.
7. Mundësisht të respektojë, aq sa është e mundur listën e barërave që posedon institucioni
  8. Të bëjë përpjekje aktive dhe të vazhdueshme për avancimin profesional dhe organizativ të punës në institucion dhe menaxhimin e rasteve me probleme të natyrës psikike.
  9. Çdo herë dhe pa ndërprerje gjatë punës të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të stafit të mesëm (infermiereve), stafit korrektues për të reduktuar rastet që kanë predispozita për vetëvrasje apo vetëlëndime.
  10. Vendimet dhe aktivitetet e tij mos të jenë në kundërshtim me rregullat e institucionit në përgjithësi
  11. Të gjitha raportet dhe evidencat të bëjë me shkrim dhe me kohë
  12. Të bëjë raporte psikiatrike për pacientet që kanë nevojë.
  13. Të jetë në thirrje për çdo konsultim eventual në raport me pacientet psikiatrik.
  14. Të jetë në gatishmëri në thirrje dhe për të shkuar në çdo kohë sipas kërkesave të institucionit;
  15. Të respektoj orarin dhe kërkesat për punë në institucion.
  16. Të organizoj trajtim, rehabilitim dhe terapi okupuese në burgje ku punon.
  17. Të jetë përgjegjës për shëndetin mendor të institucionit ku punon.
  18. Të bashkëpunoj me psikologun e NjShB për rastet specifike të punës e përbashkëta.
  19. Çdo mosmarrëveshje mund të zgjidhet në bisedë me mjekun përgjegjës të burgut.

### **13. PSIKIATER KONSULTANT**

Orari i punës:	Gjysmë normë\nnormë të plotë
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJS HB-DSHB\MSH
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohë të pa caktuar
Vendi:	NJS HB

#### *Detyrat dhe përgjegjësitë e psikiatrit në NjShB*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta, orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë), sigurinë dhe rutinën
4. Jep sugjerime Udhëheqësit të NJS HB-së dhe raporton tek ai.
5. Çdo raportim dhe çdo veprim që del jashtë suazave të kompetencave të tije duhet të shkojë përmes Udhëheqësit të NjShB.
6. Të jetë përgjegjës për punën e vetë në institucion si dhe për grupin specifik të pacientëve që janë nën përgjegjësinë e tij pa diskriminim.
7. Mundësisht të respektojë, aq sa është e mundur listën e barërave që posedon institucioni
8. Të bëjë përpjekje aktive dhe të vazhdueshme për avancimin profesional dhe organizativ të punës në institucion dhe menaxhimin e rasteve me probleme të natyrës psikike
9. Çdo herë dhe pa ndërprerje gjatë punës të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të stafit të mesëm



(infermiereve), stafit korrektues për te reduktuar rastet qe kanë predispozita për vetëvrasje apo vetëlëndime.

10. Vendimet dhe aktivitetet e tij mos te jenë në kundërshtim me rregullat e institucionit në përgjithësi
11. Të gjitha raportet dhe evidencat ti bëjë me shkrim dhe me kohë
12. Te bëjë raporte psikiatrike për pacientet qe kanë nevojë.
13. Te jetë ne thirrje për çdo konsulltim eventual ne raport me pacientet psikiatrik.
14. Të jetë ne gatishmëri ne thirrje dhe për te shkuar ne çdo kohe sipas kërkesave te institucionit;
15. Te bashkëpunoj me psikologun e NjShB për rastet specifike te punët e përbashkëta.
16. Çdo mosmarrëveshje mund të zgjidhet në bisedë me Udhëheqësin e NjShB.

## 14. TEKNIK I RADIOLOGJISE

Orari i punës:	Gjysmë norme\nnormë te plotë
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJSHB
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohë të pa caktuar
Vendi:	NJSHB

### *Detyrat dhe përgjegjësitë e teknik i radiologjisë në NjShB*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta, orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë), sigurinë dhe rutinën
4. Të menaxhoj rëntgenit dhe te gjitha pajisjet përcjellëse
5. Të bëjë menaxhimin dhe evidencën e materialit shpenzues, filmave, fiksuarve dhe te përcjell punën e aparaturës si dhe mirëmbajtjen e tyre.
6. Të beje rëntgen për te gjithë pacientet qe janë dërguar nga mjeket e institucionit.
7. Të mbaje evidence te vazhdueshme për te gjitha rastet qe janë kryer dhe te raportoj te mjeket qe kane autorizuar.
8. Të ketë kujdes te veçante ne menaxhimin e mire te pacienteve dhe institucioneve ne dozimin dhe përhapjen e rrezatimit.
9. Të jetë ne vazhdimësi i informuar dhe i kujdesshëm lidhur me menaxhimin e rrezatimit jonizues.
10. Të kujdeset për dozimeter te vet personal dhe për dozimeter te aparaturës dhe sallës.

### *Detyra e veçanta*

1. Të kryej te gjitha radiogarafit e kërkuara.
2. Të jete ne gatishmëri për thirrje te rasteve urgjente ne çdo kohe si: natën, jashtë orarit te punës, gjate festave, çdo here kur është e domosdoshme për spitalin e burgut
3. Të jete i gatshëm për pune ne rastet kur kërkohet nga konsultanti, radiologu, për përsëritje te radiografive.
4. Çdo mosmarrëveshje mund të zgjidhet në bisedë me Udhëheqësin e NjShB.

*Shtojcë:*

Tekniku i radiologjisë bënë punë specifike që i ekspozohet rrezatimit permanent radioaktiv dhe jonizues. Lidhur me këtë çështje me ligjet e ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare, kjo kategori e punëtorëve mbrohet në punë duke u kujdesur me uniforme mbrojtëse, dozimeter për matjen e sasisë së rrezatimit, ushqim shtesë, pagë shtesë dhe pushim shumë me shumë se punëtorët e tjerë (35 ditë punë brenda vitit).

Tekniku i radiologjisë është i vetmi i tillë në të gjitha institucionet korrektuese dhe nuk mund të zëvendësohet nga askush tjetër i pa kualifikuar. Si rrjedhojë e kësaj është në gatishmëri tërë kohën, pavarësisht nga orari i punës apo festat.

Bazuar në këtë është kërkuar që pagesa e tij, si kompensim për rreziqet dhe gatishmërinë të jetë me e madhe se sa e teknikeve të tjerë, njëjtë si e bënë edhe në institucionet e tjera shëndetësore.

## **15. GJINEKOLOG KONSULTANT**

Orari i punës:	Gjysmë normë\nnormë te plotë
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJSHB
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohe të pa caktuar
Vendi:	NJSHB

*Detyrat dhe përgjegjësitë e Gjinekologut Konsultant në NjShB*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta; orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë) dhe sigurinë dhe rutinën
4. Të jetë në gatishmëri në thirrje dhe për të shkuar në çdo kohe sipas kërkesave të institucionit
5. Të përpiloj raporte profesionale për pacient sipas kërkesave dhe nevojave të shërbimit.
6. Të konsultohet çdo herë me mjekun përgjegjës të pacientit për çdo veprim lidhur me të
7. Mundësisht të respektojë, aq sa është e mundur listën e barërave që posedon institucioni
8. Konsultanti jep sugjerime dhe merr vendime për sëmundjen e pacientit, ndërsa përgjegjës për aplikueshmërinë, kohën dhe mënyrën e menaxhimit të pacientit e merr mjeku përgjegjës i institucionit.
9. Çdo mosmarrëveshje mund të zgjidhet në bisedë me Udhëheqësin e NjShB.

*Detyra e veçanta*

1. Të kryej te gjitha shërbimet specialistike gjinekologjike.
2. Të bëjë edukimin shëndetësor gjinekologjik dhe parandalues për trajtimin e femrave.
3. Të bëjë përcjelljen e shtatzënisë si dhe shëndetin e femrës edhe pas lindjes.
4. Të bëjë koordinimin dhe bashkëpunimin me institucionet publike shëndetësore dhe të aplikoj të arriturat shkencore bashkëkohore në gjinekologji dhe mjekësi në përgjithësi.

## 16. RADIOLOG KONSULTANT

Orari i punës:	Gjysmë norm\Normë e plotë
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJSHB
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohe të pa caktuar
Vendi:	NJSHB

### *Detyrat dhe përgjegjësitë e Radiologut në NjShB*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta; orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë) dhe sigurinë dhe rutinën
4. Të jetë ne gatishmëri ne thirrje dhe për te shkuar ne çdo kohe sipas kërkesave te institucionit
5. Të
6. përpiloj raporte profesionale për pacient sipas kërkesave dhe nevojave te shërbimit.
7. Të konsultohet çdo herë me mjekun përgjegjës te pacientit për çdo veprim lidhur me të.
8. Mundësisht të respektojë, aq sa është e mundur listën e barërave që posedon institucioni
9. Konsulltanti jap sugjerime dhe merr vendime për sëmundjen e pacientit, ndërsa përgjegjës in për aplikueshmërinë, kohën dhe mënyrën e menaxhimit të pacientit e merr mjeku përgjegjës i institucionit
10. Çdo mosmarrëveshje mund të zgjidhet në bisedë me Udhëheqësin e NjShB..

### *Detyra e veçanta*

1. Të kryej te gjitha shërbimet specialistike radiologjike kërkuara.
2. Të lexoj, përshkruaj dhe raportoj për te gjitha radiografie e bëra ne IK.
3. Të bëjë diagnostikimin radiologjik dhe ultrasonografik ne kuadër te IK me kërkesën e mjekeve te tjerë.
4. Të bëjë përcjelljen e rasteve te rekomanduara deri ne diagnostikim përfundimtar.

## 17. ORTOPEDE KONSULTANT

Orari i punës:	Gjysmë norme\Normë e plotë
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJSHB
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohe të pa caktuar
Vendi:	NJSHB

### *Detyrat dhe përgjegjësitë e Ortopedit Konsultant në NjShB*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit
2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta; orarin e punës (vajtjet e përcaktuara më parë) dhe sigurinë dhe rutinën
4. Të jetë në gatishmëri në thirrje dhe për të shkuar në çdo kohë sipas kërkesave të institucionit
5. Të përpiloj raporte profesionale për pacient sipas kërkesave dhe nevojave të shërbimit.
6. Të konsultohet çdo herë me mjekun përgjegjës të pacientit për çdo veprim lidhur me të
7. Mundësisht të respektojë, aq sa është e mundur listën e barërave që posedon institucioni
8. Konsultanti jap sugjerime dhe merr vendime për sëmundjen e pacientit, ndërsa përgjegjësin për aplikueshmërinë, kohën dhe mënyrën e menaxhimit të pacientit e merr Udhëheqësi i NjShB
9. Çdo mosmarrëveshje mund të zgjidhet në bisedë me Udhëheqësin e NjShB.

### *Detyra e veçanta*

1. Të kryej të gjitha shërbimet specialistike ortopedike dhe të traumatologjisë të kërkuara.
2. Të bëjë trajtimin e të gjitha rasteve ortopedike, thyerjeve, kontrakturave dhe rehabilitimit adekuat post traumatologjik.
3. Përcjellë rastet specialistike edhe në institucioneve e kujdesit shëndetësor publik dhe në IK në vazhdimësi deri sa kërkojnë trajtim adekuat ortopedik.

## 18. OFTALMOLOG KONSULTANT

Orari i punës:	Gjysmë normë\nnormë te plotë
Kategoria funksionale/Grada:	
I përgjigjet:	Udhëheqësit të NJSHB
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohe të pa caktuar
Vendi:	NJSHB

### *Detyrat dhe përgjegjësitë e Oftalmologut Konsultant në NjShB*

1. Të respektoj principet e humanitetit dhe profesionalizmit

2. Të bashkëpunojë me stafin punues dhe drejtues të institucionit
3. Të respektojë specifikat e institucionit si: rregulloret e veçanta; orarin e punës, sigurinë dhe rutinën;
4. Të jetë në gatishmëri në thirrje dhe për të shkuar në çdo kohë sipas kërkesave të institucionit;
5. Të përpiloj raporte profesionale për pacient sipas kërkesave dhe nevojave të shërbimit.
6. Të konsultohet çdo herë me mjekun përgjegjës të pacientit për çdo veprim lidhur me të
7. Mundësisht të respektojë, aq sa është e mundur listën e barërave që posedon institucioni
8. Konsulltanti jap sugjerime dhe merr vendime për sëmundjen e pacientit, ndërsa përgjegjësin për aplikueshmërinë, kohën dhe mënyrën e menaxhimit të pacientit e merr Udhëheqësi i NjShB
9. Çdo mosmarrëveshje mund të zgjidhet në bisedë me Udhëheqësin e NjShB.

#### *Detyra e veçanta*

1. Të kryej të gjitha shërbimet specialistike oftalmologjike dhe përcaktim të dioptrisë në IK.
2. Te beje trajtimin e të gjitha rasteve me probleme oftalmologjike si diagnostifikim, trajtim, korrigjim të të parit dhe përcjellje të trajtimit.
3. Përcjell rastet specialistike edhe në institucioneve e kujdesit shëndetësor publik dhe në IK në vazhdimësi deri sa kërkojnë trajtim adekuat oftalmologjik.

## **19. UROLOG KONSULTANT**

Orari i punës:	Gjysmë normë\nnormë të plotë
